

VENDIM
Nr. 3, datë 22.1.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE HETIMORE ADMINISTRATIVE

Në mbështetje të nenit 14 dhe nenit 27 të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe nenit 80 e vijues i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të nisë procedurën hetimore për marrjen e masave administrative për kundërvajtjen administrative "Ushtrimi i veprimtarisë pa licencë", ndaj operatorëve:

- a) Shoqëria “Ujësjetllës-Kanalizime Kavajë” sh.a.;
- b) Shoqëria “Ujësjetllës-Kanalizime Vlorë” sh.a.;
- c) Shoqëria “Ujësjetllës Shkodër Fshat” sh.a.;
- d) Shoqëria “Ujësjetllës-Kanalizime Gjirokastër” sh.a.;
- e) Shoqëria “Ujësjetllës Novoselë” sh.a.;
- f) Shoqëria “Ujësjetllës Skrapar” sh.a.

2. Shoqëritë e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi të njoftohen dhe të thirren për t'u dëgjuar mbi objektin e procedimit, sipas grafikut bashkëlidhur.

3. Ndjek zbatimin e këtij vendimi Sektori Juridik dhe Marrëdhënieve me Publikun.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Avni Dervishi